

Bashkia: GRAMSH

Kryetar: LULJETA DOLLANI

Fusha: INFRASTRUKTURË DHE SHËRBIME PUBLIKE

Premtime:

1. Do të kryhet rikonstruksion i 4 qendrave shëndetësore në territorin e bashkisë
2. Në bashkëpunim me drejtorinë e Ujit të Pijshëm në Gramsh do të kryhet projekti për rikonstruksionin e rrjetit të brendshëm
3. Do të zgjidhet, deri në fund të mandatit, problemi me ujin e pijshëm në fshatra
4. Do të kryhet, në lagjen “Sporti 2”, projekti për lulishte, sistemim, asfaltimin, ndriçim i rrugëve si dhe ambienteve midis pallateve
5. Do të punohet për një ndërhyrje në lagjen “Ish reparti ushtarak”, lagjia poshtë agjencisë së udhëtarëve e cila më parë ka qenë jashtë juridiksionit të bashkisë për efekt të përmbytjes nga H/C Banjë
6. Do të rikonstruktohen rrugët: Gramsh-Porocan, Gramsh-Tunjë, Gramsh-Skënderbegas, Gramsh-Kukur, Gramsh-Lenie, Gramsh-Zgjupe, Gramsh-Silare
7. Do të rikonstruktohet rruga Lubinjë-Sult

Fusha: ARSIM/KULTURË/SPORT

Premtime:

8. Do të kryhet rikonstruksion dhe ndërhyrje në shkollën në Tërvol
9. Do të kryhet rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar Kukur për të cilën është bërë edhe një plan i pajisjes me bazë material didaktike dhe mësimore bashkëkohore
10. Do të kryhet rikonstruksion dhe ndërhyrje në shkollën në Kushovë
11. Do të kryhet rikonstruksion dhe ndërhyrje në shkollën në Grabovë
12. Do të kryhet rikonstruksion dhe ndërhyrje në shkollën në Tunjë

Fusha: MJEDIS/TURIZËM

Premtime:

1. Do të kryhet hartimi i një guide turistike për promovimin e resursve, si:
Hapësira liqenore që formohet nga ndërtimi H/C Banjë dhe Moglicë.
Liqeni i Dushkut dhe Uji i ftohtë i Lenies;
Ujëvara e Sotirës dhe Pylli i Skënderbegasit së bashku me Teqene e kësaj treve;
Rovja e Kukurit Grabova dhe Kërpica për akomodimin privat të turistëve;
Sporti dimëror i skive në Grabovë,
Vendbanimet e hershme, Kalaja e Tunjës, tumat ilire, Vendbanimet e herëshme shpellore si ai i Tërvolit
2. Për zhvillimin e turizmit do të kryhet nxitja e emigrantëve për investime, përkrahja e prodhimeve vendore, shndërrimi i turizmit malor dhe veror në degë bazë të ekonomisë lokale drejt një ekonomie me bazë trinomin : ekonomi-mjedis-shoqëri

Fusha: BUJQËSI

Premtime:

Fusha: TRANSPARENCA

Premtime:

1. Do të kryhet pjesëmarrja qytetare me përfshirjen e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, në proceset vendimmarrëse me qëllim krijimin ose përmirësimin e politikave publike, procedurave dhe praktikave lokale në favor të krijimit mirëqenies së tyre
2. Për tërheqjen e mendimit qytetar do të zbatohet një organigramë e plotë duke vendosur afate konkrete për takimet periodike mujore, tremujore dhe vjetore në çdo pjesë përbërëse të komunitetit tonë
3. Do të kryhen informimi periodik i publikut, edukimi dhe këshillimi, dialogu publik apo dëgjuesat qytetare
4. Do të kryhet menaxhim transparent, i përgjegjshëm, efektiv dhe efikas i buxheteve dhe shpenzimeve publike; Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve publike; Mbikëqyrja publike dhe liria e informimit
5. Do të nxitet transparenca dhe llogaridhënia në lidhje me financat publike, ndërtimin e mbrojtjeve kundër korrupsionit, për të siguruar që paratë publike janë ndarë në pjesë të barabarta dhe që interesat dhe nevojat e të varfërve dhe grupeve të marginalizuara janë adresuar në mënyrë adekuate nëpërmjet komiteteve të mbikëqyrës qytetare apo borde konsultative në çdo njësi pjesë përbërëse e bashkisë së madhe

Fusha: SHËRBIMET SOCIALE

Premtime:

1. Do të funksionojnë dy qendra për shtresat në nevojë, një për fëmijët me aftësi të kufizuara që menaxhohet dhe financohet nga bashkia si dhe ajo e shëndetit mendor e inkuadruar në shërbimin shëndetësor. Këto dy qendra do të vijojnë të funksionojnë duke rritur kapacitetet si dhe standardet e shërbimit ndaj njerëzve në nevojë

Fusha: EKONOMI DHE PUNËSIM

Premtime:

1. Do të krijohen vende pune nga uzina mekanike e Çekinit e cila në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe një Fondacion ekonomik gjerman ka hartuar projektin për përshtatje destinacioni
2. Do të hapen vende të reja pune nga vënia në funksionim e fabrikës së punimeve artistike prej thupre, druri etj. si dhe sigurimi i tregjeve të shitjes së tyre